



SHQIPËRIA EUROPIANE, DESTINACION BRENDA NESH

Raport Publik për 300 ditët e para të qeverisjes





PËRMBAJTJA

Dialog, Përgjegjshmëri, Partneritet

3

Shqipëria, vend kandidat në BE

5

Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik

15

Modernizim i të gjithë shërbimeve publike

25

Të barabartë mes të barabartëve

32



MODELI YNË I MIRËQEVERISJES



Në qendër të modelit tonë të mirëqeverisjes qëndron qytetari si siguri se pushteti është i qytetarit, detyra është e Qeverisë.

Rrethi i dytë është themelor për një shoqëri të inovacionit që gjenerohet prej bashkëpunimit me grupet e ndryshme të interesit.

Në pjesën e tretë të modelit janë shënuar fushat e progresit për Shqipërinë europiane dhe Europën si destinacion brenda nesh.

DIALOG, PËRGJEGJSHMËRI, PARTNERITET

Me këto tre fjalë mbyllet raporti publik i 100-ditëve të para të qeverisjes së Aleancës për Shqipërinë europiane. I paraqitëm në atë raport si tre fjalët kyçe të qasjes sonë të re qeverisëse dhe besojmë se 300 ditët e para të qeverisjes treguan se ne dimë të ndjekim vizionin tonë. Dimë ta jetësojmë atë dhe të bëjmë atë çfarë themi, e të themi atë çfarë bëjmë.

Ky raport i dytë i aktivitetit qeverisës përkon me një moment suksesi historik për shoqërinë shqiptare, marrjen e statusit të vendit kandidat. Ndaj dhe entuziazmi ynë është i veçantë për shkak të kontributit në progresin e qartë të bërë drejt jetësimit të një të ardhmeje më të sigurt për gjeneratat e reja shqiptare.

Në tre kapitujt e këtij raporti janë pasqyruar hapa konkretë progresi në një shumëllojshmëri fushash. Secili prej tyre përbën një premtim të mbajtur që na bën të ndihemi besimplotë në fuqinë tonë të jetësimit të angazhimeve si aspekti më i rëndësishëm për rilindjen e besimit në të ardhmen e vendit tonë.





Rilindja e besimit qytetar dhe ndërkombëtar tek Shqipëria nuk ka të bëjë vetëm me ato çfarë bëjmë, por dhe me ato çfarë duam të bëjmë. Ndaj për ne, këto 300 ditë janë një libër i rëndësishëm mësimesh për kalimin e vështirësive, evitimin e gabimeve të reja dhe zhdukjen e mundësisë së ripërtëritjes së gabimeve të vjetra.


Një raport shumë më i gjatë se ky mund të shkruhej për vështirësitë e 300 ditëve të para të qeverisjes. Ndonëse përballë arritjeve natyrshëm zbehen vështirësitë, kapërcimi i të cilave, sado komplekse, sidoqoftë mbetet detyra jonë. Detyrë, që na ka bërë të prekim çdo ditë forcën njerëzore dhe pasurinë natyrore të Shqipërisë.

E kjo na bën më të përkushtuar ndaj qeverisjes për njerëzit duke i shtuar rishtazi qasjes ndaj detyrës për vendin tonë një tjetër fjalë kyçe.

Krenari.

SHQIPËRIA, VEND KANDIDAT
NË BE







Shqipëria hapi një kapitull të ri marrëdhëniesh me BE-në. Ky kapitull nuk ka të bëjë vetëm me një seri hapash teknike, por me një vizion tjetër për Shqipërinë dhe mundësitë e vendit

tonë. Puna për të siguruar hapjen e këtij kapitulli të ri ishte mbi të gjitha vendosmëri për autoritetin shtetëror që qytetarët shqiptarë meritojnë. Ashtu siç ishte gjithashtu insistim për një Qeverisje që reflekton vlerat më të mira shqiptare dhe vlerat progresiste europiane. **Të vetëdijshëm për të sotmen dhe realistë për të nesërmen tonë ne punojmë e bashkëpunojmë me përgjegjshmëri dhe bindje se rruga e Shqipërisë drejt BE-së i shërben të ardhmes së Shqipërisë aq sa i shërben dhe të ardhmes së rajonit dhe gjithë BE-së.**



@rend dhe siguri

forca goditëse e policisë në luftën kundër kultivimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike është rritur me 51%.

#siguri #progres

Kthim i shtetit në detyrë

- ▶ Marrja e statusit të vendit kandidat për në Bashkimin Europian, përmes bashkërendimit të punës për plotësimin e 5 përparësive të vendosura nga Komisioni Europian dhe lobimit të vazhdueshëm në kancelaritë europiane.
- ▶ Fillimi i Dialogut të Nivelit të Lartë dhe realizimi i tre dialogëve të parë gjithëpërfshirës ndërmjet Shqipërisë dhe Komisionit Europian të vlerësuar nga komisioneri Stefan Fyle si “dialogët e nivelit të shkëlqyer”.
- ▶ Zhvillimi i super-operacionit të Policisë së Shtetit për shkatërrimin e vatrës kriminale në Lazarat duke sekuestruar një sasi të madhe lëndësh narkotike dhe një arsenali të tërë armatimesh, ndër to 66 ton kanabis, 480 armë zjarri, 14 antitanke, 232,309 fisheke si dhe arrestimi i 47 personave.
- ▶ Ulje me 15.3% e numrit të vrasjeve dhe 16% e krimeve të rënda ndaj personit për periudhën 10 mujore.
- ▶ Krijimi i kuadrit ligjor për rritjen dhe modernizimin e performancës së Policisë, nëpërmjet reformës më të madhe ligjore në historinë e Policisë së Shtetit që konsolidon funksionimin e policisë sipas parimeve të policimit europian.
- ▶ Ndërmarrja e operacionit të gjerë “Fund Marrëzisë” me qëllim dhënien fund aktivitetit të paligjshëm të lojërave të fatit në të gjithë vendin, aktivitet që shkaktonte një evazion

fiskal prej 110 milionë dollarë në vit.

- ▶ Konsolidim i instrumenteve financiare të shtetit duke sjellë një rritje të të ardhurave me 14% ose 18.5 miliardë lekë më shumë se në 6 mujorin e parë të vitit 2013.
- ▶ Miradministrimi i pasurisë publike duke anuluar 15 kontrata koncesionare të parregullta të dhëna para qershorit të vitit 2013.
- ▶ Përgjegjshmëri ndaj emigrantëve tanë, veçanërisht duke zgjidhur problemin e toponimeve me të cilin përballeshin 156,000 emigrantë.
- ▶ Hartimi për herë të parë i Strategjisë së Sigurisë Kombëtare në përputhje me standardet e NATO-s.
- ▶ Rivendosja në punë e sistemit të vëzhgimit duke vënë në kontroll total hapësirën detare.
- ▶ Vendosmëri për të qenë anëtarë të denjë të Aleancës së Atlantikut të Veriut me anë të pjesëmarrjes aktive në misionet e përbashkëta të NATO-s, duke plotësuar detyrimet dhe rritur prestigjin e Forcave të Armatosura.

Luftë me korrupsionin

- ▶ Rritje me 45% e fuqisë goditëse të policisë kundër akteve korruptive dhe autorëve të tyre në fusha të ndryshme si: administrata publike, arsimi, shëndetësia dhe shërbime të tjera publike.
- ▶ Ngritja e portalit “Stop Korrupsionit në Drejtësi”, që siguron bashkëpunim me publikun për rastet e korrupsionit në sistemin

e drejtësisë dhe deri më tani janë raportuar mbi 760 raste korrupsioni.

- ▶ Dorëzimi në prokurori i 8 dosjeve hetimore të korrupsionit për zyrtarë dhe ushtarakë të lartë të Forcave të Armatosura.
- ▶ Instalimi i një sistemi modern kamerash në makinat e patrullave të repartit “Shqiponja” dhe Qarkullimit Rrugor të Tiranës, duke siguruar kontroll më të mirë të territorit, të punës së policisë dhe transparencë për publikun.
- ▶ Ndryshimi i Kodit të Procedurës Penale në lidhje me kufizimin e imuniteteve dhe trajtimin e veprave penale të korrupsionit si krime të rënda.
- ▶ Përfundimi i Strategjisë Kombëtare kundër Korrupsionit dhe hartimi i Planit të Veprimit kundër Korrupsionit 2014-2017, pas konsultimeve me më shumë se 500 përfaqësues institucionesh dhe grupe interesi.
- ▶ Funksionalizimi i rrjetit të pikave të kontaktit kundër korrupsionit i përbërë nga 57 zyrtarë, nga të cilët 12 për herë të parë në nivel prefekturë.
- ▶ Hartimi i legjislacionit për informatorët e rasteve të korrupsionit dhe mbrojtjen e tyre si dhe hartimi i sistemit elektronik për mbledhjen dhe gjurmimin e statistikave të rasteve korruptive.

Vendosmëri kundër krimit të organizuar

- ▶ Shkatërrimi i bandës së vrasësve me pagesë përmes hetimeve të gjithanshme nga Policia e Shtetit, e cila për herë të parë arriti të zbardhë zinxhirin e plotë që nga porositësit e vrasjeve, te ndërmjetësit deri tek ekzekutorët.
- ▶ Goditja e grupit të strukturuar kriminal të eksplozivëve ku u kap sasia rekord prej 96 kg C4, 37 kg fitil detonator, 3,744 copë ndezës minash dhe mbi 7,150 kapsolla detonatorë të llojeve të ndryshme.
- ▶ Rritje me 51% e forcës goditëse të policisë në luftën kundër kultivimit dhe trafikimit të drogës. Sasia e marijuanës së kapur është rritur 404 % ndërkohë që sasia e kokainës së kapur është rritur 7.5 herë.
- ▶ Rritje me 36% e fuqisë goditëse të policisë kundër krimit të organizuar dhe trafikëve të paligjshme, duke përdorur metodat speciale të hetimit.
- ▶ Rigjallërimi i mekanizmit kombëtar antitrafik përmes ngritjes së tri njësive të lëvizshme në Tiranë, Vlorë dhe Elbasan, që ka sjellë identifikimin e 57 viktimave të mundshme të trafikut.
- ▶ Vënia në funksion e linjës kombëtare “116006” për raportimin e rasteve të trafikimit të personave.
- ▶ Krijimi i aplikacionit për telefonat celularë “Raporto dhe Shpëto” që mundëson lidhjen e drejtpërdrejt me autoritetet përgjegjëse në rast të konstatimit të rasteve të trafikimit.
- ▶ Shtimi i elementit të identifikimit të fytyrës në

pasaportat biometrike që e bën sistemin shqiptar të dokumenteve të identitetit një nga sistemet e parë në Europë me kombinimin e biometrive të gjurmëve të gishtave dhe njohjes së fytyrës.

- ▶ Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit shënon daljen e Shqipërisë nga zona nën vëzhgim e grupit 2.

Modernizim dhe goditje informalitetit

- ▶ Nisi epoka e legalizimeve falas, me lejet e shpërndara për të vetëdeklaruarit nga viti 2006, kryerjen e procedurave në terren për 10-mijë objekte, dhe çeljet e zyrave të legalizimeve në çdo zonë informale ku në Tiranë janë hapur 10 zyra.
- ▶ Rikthimi i rendit ligjor e mjedisor në bregdet dhe akset kombëtare ku janë prishur në total mbi 360 ndërtime të paligjshme.
- ▶ Auditimi i shpërndarjes së Ndihmës Ekonomike ka mundur kapjen e 20,000 abuzuesve që e përfitonin atë padrejtësisht.
- ▶ Reduktimi me 6% i nivelit të humbjeve dhe rritje me 30% e arkëtimeve në sektorin e shpërndarjes së energjisë, ndërprerja e 2,675 lidhjeve të paligjshme dhe e energjisë për 242,712 abonentë debitorë.
- ▶ Arkëtimi i 1,723 miliardë lekë nga aksioni i Task Forcës në sektorin e furnizimit me energji elektrike dhe kryerja e 725 denoncimeve në prokurori për abuzime dhe vjedhje të energjisë.

- ▶ Disiplinimi i tregut të hidrokarbureve: 238% më shumë inspekte për respektimin e kushteve teknike, 208% më shumë inspekte për standardin e hidrokarbureve, 217% më shumë masa të marra pas konstatimit të shmangies nga standardi i cilësisë së karburanteve.
- ▶ Dhënia fund e “tregut të zi” të licencave në energjetikë dhe miniera duke anuluar mbi 200 leje e kontrata që nuk përmbushnin kriteret ligjore dhe detyrimet ndaj shtetit.
- ▶ Përmirësim tekniko-ligjor në fushën minerare dhe revokim e pezullim i rreth 160 lejeve minerare të cilat janë konstatuar me mos respektim të kërkesave ligjore.
- ▶ Krijimi për herë të parë i Regjistrat Kombëtar të Përdoruesve të Burimeve Ujore që solli evidentimin e 1450 subjekteve të cilat përdomin burimet ujore në kundërshtim me ligjin.
- ▶ Forcimi i kontroleve (400 në muaj) ndaj evazionit në mallrat e akcizës dhe zbatim i barabartë i kodit doganor nëpërmjet asistencës së Crown Agents.
- ▶ Rritja e të ardhurave nga Doganat me 12.9% më shumë se 6-mujori i njëjtë i 2013.
- ▶ Rritja e të ardhurave nga Tatimet me 17.12% më shumë se 6-mujori i njëjtë i 2013.

Meritokraci dhe profesionalizëm në Qeverisje

- ▶ Përfundimi i kuadrit të ri ligjor për statusin e nëpunësit civil, një hap themelor drejt administratës publike të standardeve

europiane.

- ▶ Vlerësimi i performancës së drejtuesve në 38 Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat e Arsimit nëpërmjet votimit të fshehtë të të gjithë mësuesve.
- ▶ Rritja e pagave të punonjësve të policisë në masën 25% duke u dhënë përparësi niveleve të rolit bazë dhe punonjësve të terrenit. Kjo përbën rritjen më të madhe të pagave në historinë e Policisë së Shtetit.
- ▶ Sigurim i veçantë shëndetësor për mbi 500 punonjësit e Forcave Speciale të Policisë së Shtetit, të cilët do të përfitojnë kontroll periodik shëndetësor të specializuar falas dhe të gjitha ndërhyrjet e tjera mjekësore e kirurgjikale brenda dhe jashtë vendit.
- ▶ Miratimi i ligjit të ri që synon rregullimin e procedurave të punësimit, ngritjes në karrierë, transferimit dhe mënyrës së trajtimit financiar të punonjësve të Policisë së Burgjeve.
- ▶ Transparencë për sistemin e gradave dhe karrierës në Forcat e Armatosura dhe strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes përmes rishikimit të strategjisë së mbrojtjes dhe rivlerësimit të gjithë bazës ligjore.
- ▶ Ngritja e 4 sallave teknologjike për trajnimin dhe kryerjen e testeve të nëpunësve të administratës civile, zhvillimi në total i 72 temave dhe 82 kurseve të trajnimit me nëpunës civilë të të gjithë niveleve.
- ▶ Trajnimi i veçantë i mbi 500 punonjësve të

Drejtorive të Tatimeve, Doganave, Lojërave të Fatit dhe Ministrisë të Financave.

- ▶ Përfitimi i ekspertizës, përmes nënshkrimit të një sërë marrëveshjeve të rëndësishme Europiane, për trajnimin e stafeve në institucione të kulturës, trajnimin e përkthyesve dhe botuesve, dhe rievimin e monumenteve në Gjirokastrë.
- ▶ Raporti i Freedom House shënon përparim të demokracisë krahasuar me vitin e kaluar veçanërisht për qeverisjen demokratike në nivel qendror.

Epokë e re bashkëpunimi me Kosovën dhe rajonin

- ▶ Filloi ndërtimi i linjës 400 kV të interkonjeksionit Shqipëri – Kosovë, si dhe është miratuar ndërtimi i linjës 110kV Kukës – Prizren në kuadër të angazhimit për krijimin e tregut të përbashkët energjetik mes dy vendeve.
- ▶ U realizua për herë të parë në historinë e dy vendeve unifikimi i kurrikulave për sistemin arsimor parauniversitar.
- ▶ Heqja e lejeve të punës për qytetarët shqiptarë të Republikës së Kosovës dhe shtetasit e Republikës së Serbisë të përkatësisë etnike shqiptare që duan të punojnë në Shqipëri.
- ▶ Transferimi i fondit 100,000 mijë euro për Komunën e Preshevës për nevojat e funksionimit normal të maternitetit të kësaj komune.

- ▶ Realizimi me sukses i dy ndërhyrjeve të para kardiokirurgjikale në Prishtinë në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit Shqipëri-Kosovë të nënshkruar në muajin prill nga ministrat përkatës të shëndetësisë
- ▶ Hartimi i paketës së përbashkët turistike Kosovë – Shqipëri – Rajon.
- ▶ Hartimi i një kalendarit të përbashkët kulturor me Kosovën që synon të përfshijë rreth 600-mijë persona në aktivitetet e planifikuara gjatë gjithë vitit.
- ▶ Heqja e taksimit të dyfishtë midis Kosovës dhe Shqipërisë, si dhe eliminimi i TVSH-së për librat, revistat dhe materialet e tjera që lidhen me fushën e edukimit dhe shkencës.
- ▶ Nënshkrimi i marrëveshjes për përkthimin e legjislacionit midis Shqipërisë dhe Kosovës, në funksion të integritetit të përbashkët në BE.
- ▶ Lehtësimi i bashkëpunimit në fushën e transportit rrugor të mallrave dhe udhëtarëve me Kosovën dhe Maqedoninë në kuadër të përgatitjeve për sezonin turistik.
- ▶ Ngritja e grupeve të punës Shqipëri-Kosovë për mirëmbajtjen e "Rrugës së Kombit".

Mbrojtja e vlerave dhe trashëgimisë sonë


- ▶ Përfshirja e rreth 20 mijë nxënësve në aksionin "Miq të Monumentit" që synon mbrojtjen e monumenteve dhe trashëgimisë kulturore.
- ▶ Reforma institucionale në Trashëgiminë Kulturore që ka pajisur Drejtoritë Rajonale të Kulturës Kombëtare me një bërthamë ekspertize për menaxhimin e fokusuar të monumenteve.
- ▶ Zhvillimi i konkursit ndërkombëtar për muzeun "Marubi" për të nxjerrë në dritë thesarin e plotë dhe të harruar kulturor të fototekës së familjes Marubi.
- ▶ Shfuqizimi i VKM-ve që bien ndesh me ligjin për trashëgiminë kulturore dhe shfuqizimi i vendimit për privatizimin e Kalasë të Lezhës.
- ▶ Shpëtimi i thesarit prej 477 ikonash, pikturash murale dhe enëve të bronzit, gjatë operacionit më të madh antitrafik në fushën e mbrojtjes së vlerave të trashëgimisë kulturore.
- ▶ Garantohet akses i organizatave shqiptare të artit dhe kulturës në aplikimin për fondin european "Creative Europe".




@foreign policy

Shqipëria 18 vende për mirësim nga 2013 për investimet e huaja.
#foreignpolicymagazine #progres #siguri

ZHVILLIM I
QËNDRUESHËM EKONOMIK







Modeli i ri ekonomik për të cilin është angazhuar Qeverisja e Aleancës për Shqipërinë Europiane, në 300 ditët e para të qeverisjes, kërkonte ndërthurjen e masave afatgjata me ndërhyrje emergjente në një seri sektorësh nga turizmi në financë. Synimi kryesor ishte hedhja e hapave stabilizues dhe transformues njëkohësisht për të vlerësuar potencialet e vendit tonë dhe rilindur besimin tek ai. Siç është deklaruar dhe në programin e qeverisjes **modeli i ri ekonomik ka në qendër rritjen e punësimit, të cilit i shërbejnë politikat tona, në çdo sektor të zhvillimit të vendit.** Sinjalet e dhëna nga ekonomia tregojnë se kemi ditur të hedhim hapat e duhur drejt këtij modeli.



@albp petrol

rit kontributet në buxhetin e shtetit shqiptar me 11 mln dollarë ose 63% më shumë se 2013

#progres

@tatimet

ritje të ardhurash me 17.12% më shumë se 6-mujori i njëjtë i 2013

#siguri #progres

Me shumë punësim

- ▶ Që në vitin e parë të Qeverisjes janë shtuar 43.000 vende të reja pune të regjistruara në sistemin e tatimeve.
- ▶ Hapja e 7 zyrave moderne të punës në qytetet e Tiranës, Durrësit, Elbasanit, Vlorës, Kavajës, Gjirokastrës dhe Korçës të cilat kanë ofruar 11,590 vende të lira të punës dhe ndërmjetësuar punësimin e mbi 6,000 personave deri më tani.
- ▶ Hartim i Strategjisë së Re Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2014-2020 që rrit 10% numrin e pjesëmarrësve në programet e punësimit dhe ka shtuar me 40% punësimin e personave të dalë nga arsimi profesional nga të cilët 25% janë vajza.
- ▶ Lançimi dhe hapja e aplikimeve për 6 programet e Fondit të Nxitjes së Punësimit.
- ▶ Është trefishuar Fondi i Nxitjes së Punësimit nga 900 mijë USD në 2.7 milion USD, është katërfishuar numri i bizneseve aplikuese, kanë përfituar 280 biznese dhe janë punësuar mbi 3,000 persona.
- ▶ Realizimi dhe implementimi sipas sugjerimeve të biznesit të "Paketës Fason" që ka sjellë lehtësimin e kushteve për biznes dhe ka rritur punësimin duke shtuar eksportet në vetëm 5 mujin e parë me mbi 80 milion USD.

Mbështetje bujqësisë

- ▶ Fillimi i implementimit për skemat e mbështetjes në bujqësi të cilat kanë filluar t'i

japin një dinamizëm të ri prodhimit bujqësor në vend.

- ▶ Shpërndarja e 100 certifikatave të para të pronësisë së tokës.
- ▶ Rritja e eksporteve në prodhimet bujqësore me 19% në tre mujin e parë të këtij viti.
- ▶ Rritja e mbështetjes financiare në bujqësi nëpërmjet subvencioneve me 60% duke ulur kështu dhe sipërfaqen e tokave të lëna djerrë.
- ▶ Është ritur mbështetja më naftë për serat me ngrohje dhe 50 hektarë sera tanimë punojnë me ngrohje dimërore.
- ▶ Vënia në funksionim e laboratorit të Lushnjës që u shërben fermerëve duke i analizuar produktet afër vendit të prodhimit dhe në gamë më të gjerë.

Zhvillim i territorit dhe potencialeve të vendit

- ▶ Procesi gjithëpërfshirës i formësimit të reformës administrativo-territoriale i bazuar në konsultime në mbarë vendin me mbi 20.000 persona.
- ▶ Miratimi i kriterëve teknike dhe paraqitja e një ndarje të re administrativo-territoriale bazuar në konceptin modern të "zonave funksionale" për efikasitet të shërbimeve publike dhe fuqizim të qeverisjes vendore.
- ▶ Hartim i Strategjisë së re për Turizmin 2014-2020, ku përcaktohet qartë planifikimi i zhvillimit të destinacioneve turistike dhe jepen drejtimet strategjike për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm.

- ▶ Pajisja me kulla vrojtimi e 7 plazheve pilot, trajnimi i rojeve bregdetare dhe trajnimi i guidave të para turistike sipas standardeve ndërkombëtare.
- ▶ Garantimi me VKM i paprekshmërisë së sipërfaqes së plazheve publike në raport me privatin në masën 20%.
- ▶ Ripërtëritje e Pikave të Informacionit në kufij, në funksion të shërbimeve informuese cilësore për turistët
- ▶ Zhvillimi i konkursit ndërkombëtar “Branding Albania” për përzgjedhjen e logos, sloganit dhe fushatës së promovimit në turizëm dhe investime për Shqipërinë.
- ▶ Zhvillimi i konkursit ndërkombëtar për rigjenerimin e vijës bregdetare të Vlorës.
- ▶ Krijimi i ATELIER Albania dhe hartimi i disa projekteve pilot, në fushën e planifikimit urban me fokus zhvillimin e turizmit dhe rigjenerimin e qendrave urbane.
- ▶ Objekte shtetërore me qira 1 euro për investorët e huaj.
- ▶ Promovimi i markës “Made in Albania” dhe eksporti për herë të parë i bimëve mjekësore me markën “Made in Albania” në USA.
- ▶ Dyfishimi i Fondit të Zhvillimit të Rajoneve me 72 projekte të infrastrukturës dhe urbanizimit të komunave, bashkive e zonave turistike që nisën punën këtë vit dhe me 72 projekte të tjera për infrastrukturën arsimore të miratuara anembanë Shqipërisë.

Standarde ndërkombëtare në infrastrukturë

- ▶ Hapja e linjës së tragetit Pogradec-Ohër që ka sjellë lehtësimin e transportit në njerëz midis dy vendeve.
- ▶ Prishja e monopoleve të operatorëve të transportit ajror dhe ulja me 30% e çmimit të biletës drejt Italisë, që ka rezultuar në rritjen e fluksit të pasagjerëve për periudhën janar-prill 2014 në këto linja.
- ▶ Zbatimi i planit për mbarëvajtjen e rrugëve dhe sigurisë rrugore. Dyfishim i buxheti për mbarëvajtjen e rrugëve nga 1,2 miliardë lekë në 2013 në 2 miliardë lekë në 2014.
- ▶ Përfundimi i planit për rikonstruktimin e shërbimit të transportit ndërqytetës ku operojnë 467 linja me riorganizim të shpërndarjes, rritje të frekuencave të udhëtimeve dhe standarde operimi të unifikuara.
- ▶ Albpetrol sh.a. rrit të ardhurat e shtetit shqiptar nga industria e naftës me 1,12 miliardë lekë të reja si rrjedhojë e administrimit më të mirë të shoqërive me kapital shtetëror.

Rritje e cilësisë së mjedisit

- ▶ Ndalimi me ligj i importit të mbetjeve.
- ▶ Moratorium 2 vjeçar për gjuetinë që ndalon shfarosjen e faunës së egër. Gjithashtu investim në shtimin e popullatave në zhdukje dhe popullim me specie të zhdukura.
- ▶ Zbatimi i Platformës për mbjelljen e 10 milionë fidanëve deri në vitin 2017.

Shtimi i sipërfaqeve të pyllëzuara nëpërmjet pyllëzimit të sipërfaqeve të zhveshura. Deri tani janë mbjellë 520 mijë fidanë të rinj në mbarë vendin.

- ▶ Ndalimi i eksportit të drurëve të zjarrit dhe qymyrit të drurit ka bërë të mundur ndalimin e prerjes së 100,000 m³ dru zjarri për 1 vit.
- ▶ Fillimi i punimeve për rehabilitimin dhe pyllëzimin e zonave të mbrojtura dhe disa prej zonave të degraduara në vend si Parku Kombëtar Lurë, Parku Divjakë-Karavasta, Shëtitorja e Bregut të Drinit në Lezhë Kodër dhe Kodër Vila në Durrës.
- ▶ Sekuestrimi i mbi 10,000m³ lëndëve drusore, ose 10 herë më shumë në krahasim me vitin e shkuar dhe kontrolli i 430 subjekte që ushtrojnë aktivitete në fondin pyjor të cilat prej vitesh ishin jashtë kontrollit.
- ▶ Inspektimi i të gjitha komunave dhe bashkive dhe vënia e gjobave ndaj të zgjedhurve të pushtetit vendor të cilët nuk kanë marrë masat e duhura në lidhje me menaxhimin e integruar të mbetjeve.
- ▶ Krijimi i Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave që mundësoi ndarjen e funksioneve menaxhuese nga ato kontrolluese në të gjitha nivelet duke rritur efikasitetin e kontrolleve.
- ▶ Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Pyjeve dhe Ujërave, në bashkëpunim me Forcat e Armatosura të Shqipërisë realizoi aksionin për pastrimin e rrugëve nacionale dhe pikave

kufitare duke pastruar 450 kilometra dhe mbledhur 450 tonë mbetjeve në kuadër të Emergjencës Mjedisore

- ▶ Pastrimi nga Forcat e Armatosura i disa hotspoteve, si ai i Qafës së Laçit në qarkun e Shkodrës, Sukthit në qarkun e Durrësit dhe Jerovenit e Bigasit në qarkun e Beratit. Vijon puna për pastrimin e Gërdecit.
- ▶ Ristrukturimi i agjencisë së mjedisit me pajisje të reja sipas standardeve ISO 17020. Vendosja e 6 stacioneve të monitorimit të cilësisë së ajrit dhe të ujit, njëri prej të cilëve i lëvizshëm.
- ▶ Vendosja e rendit mjedisor në zonën historike të Krujës me mbylljen e 25 guroreve të paligjshme dhe 109 furrave abuzive të gëlqeres.

Marrëdhënie e re me biznesin

- ▶ Rimbursimi i TVSH-së brenda 60 ditëve nga paraqitja e kërkesës në ndihmë të rimëkëmbjes së biznesit.
- ▶ Shlyerja e pagesave të prapambetura me vlerën 25 miliardë lekë për 600 firma, për të përmirësuar kushtet e bizneseve.
- ▶ Rishikimi i legjislacionit fiskal për TVSH-në dhe ligjin e tatimit mbi të ardhurat dhe hartimi paketës për lehtësimin e procedurave tatimore dhe doganore.

- ▶ Falja e gjobve të vendosura gjatë periudhës elektorale ndaj biznesit për t'i dhënë fund presionit të politikës së vjetër në sipërmarrje.
- ▶ Luftë praktikave monopoliste dhe marja e masave për të siguruar komunikimin qeveri-biznes si një themel për të kaluar në nivelin tjetër të zhvillimit ekonomik.
- ▶ Reforma për përmirësimin e klimës së biznesit duke lehtësuar procedurat dhe nxitur konkurrencën e SME-ve në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë (USAID, GIZ, IFC, BB, EBRD).
- ▶ Institucionalizimi i marrëdhënies së re me biznesin në sajë të marrëveshjeve me FMN-në, BB-në; memorandumit me BERZH, partneritetit me Këshillin e investimeve "Doing Business Reform", formimit të Këshilli Ekonomik Kombëtar dhe operimit IFC-KEK.
- ▶ Shqipëria përmirësohet me 18 vende në Indeksin "Ku të investosh në botë" të Foreign Policy për vitin 2014.

Transformim i marrëdhënies me partnerët ndërkombëtarë

- ▶ Nënshkrimi i projektit STAR me vlerën 1.5 milionë USD si mbështetje financiare dhe teknike për zbatimin e reformës administrativo-territoriale nga qeveria e SHBA-së, Suedisë, Zvicrës dhe UNDP. Pritet kontributi i qeverisë së Italisë për fazën e zbatimit të reformës.

- ▶ Zgjidhja e konfliktit të trashëguar me kompaninë CEZ Shpërndarje, i cili po thellonte kolapsin financiar të sistemit. Sigurimi i 150 milionë USD nga Banka Botërore për investime të menjëhershme.
- ▶ Përthithja dhe rivitalizimi i rreth 15 milionë USD grante nga organizma të huaja për zbatim të disa projekteve në energji dhe hidrokarbure.
- ▶ Bashkimi European miratoi financimin 1.1 milionë euro të masterplanit të gazit në Shqipëri. Marrëveshje me qeverinë e Azerbajxhanit për të mbështetur gazifikimin e vendit në kuadër të gazsjellësit TAP
- ▶ Financimi nga BERZH i regjistrit elektronik të koncesioneve dhe përfundimi i projektit teknik.
- ▶ Intensifikimi i marrëdhënieve me Vendet e Gjirit me anë të Protokolleve të Komisioneve të Përbashkëta Ndërqeveritare për bashkëpunimin ekonomik, koordinim dhe organizim të Forumeve Ekonomike.
- ▶ Organizimi i forumeve ekonomike me Rumaninë, Slloveninë, Bullgarinë, Brazilin, Indonezinë, Maqedoninë dhe Austrinë.
- ▶ Nisja e hartimit të Strategjisë së re Ndërsektoriale të Decentralizimit dhe Qeverisjes Vendore me mbështetjen e donatorëve USAID, OSBE, Këshilli i Europës, Agjencia Zvicerane për Zhvillim (SDC).



@dogana

ritje të ardhurash me 12.9% më shumë se 6-mujori i njëjtë i 2013.
#siguri #progres

@ekonomi

paketa fason me 46 masa të konsultuara me sipërmarrjen e para të këtij
lloji në Shqipëri.
#siguri #progres #inovacion




@bujqësi

Fondi i dedukuar bujqësisë rritet me 71%
#siguri #progres

@punësim

zyrat e punës kanë ofruar 11,590 vende të lira pune dhe
ndërmjetësuar punësimin e mbi 6,000 personave.
#siguri #progres #inovacion

**MODERNIZIM I TË GJITHË
SHËRBIMEVE PUBLIKE**







Ne jemi të vendosur të ndryshojmë traditën e reformave pa zbatim.

Ndaj, konkretizimi i shërbimeve publike moderne mbetet në krye të listës së prioriteteve të qeverisjes sonë. Në

jetësimin e këtij prioriteti principet tona bazë mbeten barazia e shanseve dhe demokracia e çdo dite, të cilat sigurojnë një tërësi mundësish cilësore zhvillimi personal dhe cilësi jetese për qytetarët sot dhe gjeneratat e reja nesër. Në shërbim të këtyre principeve ne vumë një seri hapash konkretë që ndryshimi në vullnet, vizion dhe qasje ndaj qeverisjes të reflektohet sa më shpejt në jetën e përditshme të qytetarëve.



@shëndetësi

Fondi limit i barnave spitalore është rritur me 15.2% krahasuar me 2013
#siguri #progres

Ekselencë në arsim

- ▶ Hartimi i "Raportit Përfundimtar për Reformën në Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor", nga një Komision i pavarur gjatë një procesi që përfshiu të gjithë aktorët dhe grupet e interesit.
- ▶ Për herë të parë u krye një proces verifikimi i kriterëve të ligjshmërisë së të gjitha institucioneve të Arsimit të Lartë, një hap i rëndësishëm drejt implementimit të reformës në arsimin e lartë.
- ▶ Kontraktimi i një agjencie të huaj akreditimi për vlerësimin e 15 institucioneve të arsimit të lartë publik dhe 44 institucioneve jopublike.
- ▶ 120 tituj librash mësimorë me probleme u hoqën nga katalogu i vitit 2014 pas konsultimit me mësuesit, prindërit dhe shtëpitë botuese.
- ▶ Realizimi i reformës kurrikulare në arsimin para-universitar jetësoi kalimin nga kurrikula e bazuar në logjikën e lëndës, tek kurrikula e bazuar në kompetencat.
- ▶ Hartimi për herë të parë i "Kartës së Performancës së Shkollës" që u shërben mësuesve, prindërve dhe nxënësve për analizën e rezultateve mësimore.
- ▶ Administrimi i maturës shtetërore u realizua në mënyrë të sigurt dhe inovatore.
- ▶ Kufiri minimal i kalueshmërisë u rrit për herë të parë me 20% dhe ndryshe nga vitet e tjera u deklarua përpara fillimit të provimeve.
- ▶ Nisja e zbatimit të projektit pilot për dixhitalizimin e arsimit, përdorimit të platformës së menaxhimit të klasës dhe shkollës, përdorimit të tabletave dhe përmbajtjes dixhitale.
- ▶ Në 66 shkolla 9-vjeçare dhe të mesme ka

nisur zbatimin e projektit të shkollës si qendër komunitare. Programi zhvillohet nga vetë shkollat në bazë të specifikës së tyre, duke promovuar bashkëpunimin mësues-prind-nxënës.

Reformim i shërbimeve shëndetësore

- ▶ Buxheti për shëndetësinë, më i larti në 10 vitet e fundit u rrit me 9,1% krahasuar me vitin 2013, duke u ngritur në nivelet e 2,77% të Prodhimit të Brendshëm Bruto.
- ▶ Heqja e TVSH-së prej 10% për barnat.
- ▶ Ulja me mesatarisht 20% e çmimeve të barnave pas negociimit, të vendimit për ndryshimin e marzheve të tregtimit të barnave në vend dhe pas heqjes së TVSH-së prej 10%.
- ▶ Lista e barnave të rimbursueshëm për vitin 2014 zgjerohet me 55 barna ose principe të reja aktive, duke e çuar në 477 numrin e barnave të rimbursueshme ose më tepër se katër vitet e fundit marrë së bashku.
- ▶ Sigurimi i furnizimit më të gjerë i barnave thelbësore spitalore pas rritjes së fondit për këtë zë me 15% në krahasim me vitin paraardhës. Listës i'u shtuan 198 barna të reja, duke rritur numrin në 525 barnave për këtë vit.
- ▶ Miratimi i 10 paketave të para pa pagesë të shërbimeve mjekësore spitalore të financuara 100% nga qeveria, si në shërbimin publik spitalor, ashtu edhe në atë jo-publik. Paketat përfshijnë shërbime të nefrologjisë, kardiologjisë, kardiokirurgjisë dhe impiantit koklear.
- ▶ Fuqizimi i ndjeshëm i kapaciteteve diagnostikuese dhe përmirësimi i bazës së pajisjeve mjekësore të shërbimeve

spitalore me krijimin e kabineteve të reja të specializuara si dhe rivënia në punë e pajisjeve të dëmtuara.

- ▶ Rritja me 29,4% e fondit për QSUT-në që mundësoi dhe normalizimin e furnizimit në vijimësi me barna dhe siguroi mbarëvajtjen e pajisjeve mjekësore.
- ▶ Për herë të parë pas 23 vitesh nisi zbatimi i një programi të plotë dezinfektimi i bregdetit me agjentë tërësisht biologjikë, me fokus ndërhyrjet për kontrollin e mushkonjave, duke ruajtur biodiversitetin dhe shmangur ndotjen kimike të mjedisit.
- ▶ Përfundoi rikonstrukcioni i plotë i bllokut operator dhe infrastrukturës ndihmëse në Shërbimin e Djegie-Plastikës.
- ▶ Përfundoi instalimi i pajisjes radioterapeutike të akseleratorit linear në shërbimin e neurologjisë në QSUT, që rrit cilësisht trajtimin dhe kurimin e çdo pacienti me kancer dhe sëmundje tumorale në të gjithë trupin.

Akses në drejtësi dhe solidaritet social

- ▶ Miratimi i projektligjit për ndryshimet në skemën e pensioneve në bashkëpunim intensiv me partnerët ndërkombëtarë për të arritur drejtësi sociale, solidaritet dhe efikasitet financiar.
- ▶ Përfundoi shlyerja e kështit të parë të dëmshpërblimit për më shumë se 1,100 ish-të dënuarve politikë ose trashëgimtarë të tyre.
- ▶ Fondi prej 18 milionë dollarësh për dëmshpërblimin e ish-të përndjekurve është më i larti ndonjëherë.
- ▶ Nis zbatimi i planit dhe fushata e ndërgjegjësimit për trajtimin e fenomenit të fëmijëve në situatë ruge.

- ▶ Miratimi i ligjit kuadër për personat me aftësi të kufizuar që sjell përfshirje më të lartë sociale me përfitime direkte për 160-170 mijë persona me aftësi të kufizuar.
- ▶ Në përputhje me rekomandimet e progres raportit hynë në fuqi tarifat e reduktuara për shërbimet gjyqësore, noteriale, përmbartuese dhe të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.
- ▶ Hartimi i Strategjisë Kombëtare të Strehimit në bashkëpunim me PNUD-in dhe TAIEX-in si dhe lidhja e marrëveshjeve për ndërtimin e objekteve me kosto të ulët për strehimin social, në bashkëpunim me Bashkitë e Fierit, Korçës, Lushnjës dhe Beratit.
- ▶ Zbatimi i projektit pilot në qytetin e Lezhës, në kuadër të efikasitetit të energjisë.
- ▶ Me vendim të Këshillit të Ministarve ndihma ekonomike u jepet vetëm grave me qëllim forcimin e pozicionit të gruas në familje dhe mbështetjen e barazisë gjinore.

Mirëqeverisje përmes inovacionit

- ▶ Dixhitalizimi i shpërndarjes së Ndihmës Ekonomike në qarqet e Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit, me qëllim transparencën, lehtësimin e procedurave dhe shmangien e abuzimeve.
- ▶ Modernizimi dhe dixhitalizimi i të dhënave të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Inventarizimi i arshivës të AKKP-së përmes skanimit të gjithë vendimeve të dhëna nga agjencia dhe krijimit të regjistrit elektronik të vendimarrjes në procesin e njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronave nga që viti 1993.
- ▶ Vendoset për herë të parë në funksionim gjeoportali kombëtar, i cili shman mbivendosjet e pronësisë dhe eliminon

burokracinë. Krijimi i gjeoportalit kombëtar siguron informacion dhe akses të saktë në hartat topografike, hartat e kufijve administrativë, hartën e treguesve të pasurive të paluajtshme dhe hartën e vlerës së pronës.

- ▶ Zbatimi i nënshkrimit elektronik “e-signature” në ofrimin e shërbimeve në portalin qeveritar “e-Albania” që redukton burokracinë dhe ul kostot për biznesin e institucionet.
- ▶ Portali unik qeveritar “e-Albania” që mundëson realizimin e deklaramit të të ardhurave personale për të gjithë individët që kanë këtë detyrim, duke lehtësuar procedurën dhe reduktuar barrierat administrative.
- ▶ Menaxhimi informatik i burimeve njerëzore në administratën publike që mundëson centralizimin dhe uniformizimin e të dhënave dhe një nivel më të lartë sigurie të të dhënave personale të punonjësve.
- ▶ 13 angazhime konkrete nga institucionet publike u morën pas miratimit të planit të veprimit për qeverisje të hapur 2014-2016, 400 shoqata dhe OJF u përfshinë në konsultim dhe 3 angazhime u hartuan tërësisht nga grupet e interesit të përfshira në planin e veprimit.
- ▶ Ngritja e portalit të e-inspektimit, në bashkëpunim me USAID-in, që mundëson përfshirjen e të gjithë inspektorateve në të njëjtin sistem.
- ▶ Përfundoi ndërtimi i “one stop shop” në 9 Komisariate Policie që tashmë mund të ofrojnë të gjithë shërbimet në një sportel të vetëm, duke kursyer kohë, dhe rritur efikasitetin.
- ▶ Stampimi i kartave të para të inspektorëve

të inspektoratit të Punës. Karta e Inspektorit Shtetëror ka si qëllim identifikimin e inspektorit gjatë kryerjes së procedurave, duke shmangur abuzimet nga persona të paautorizuar.

- ▶ Vula e cilësisë, e cila i është akorduar deri më tani shtatë subjekteve të prodhimit të verës, vajit të ullirit dhe mjaltit do të risë cilësinë ushqimore dhe konsolidojë markat e prodhimit vendas.
- ▶ Portali ndërgjegjësues/informues për sigurinë kibernetike i shërben të gjithë përdoruesve të internetit nëpërmjet informacioneve më të fundit në fushën e sigurisë kibernetike dhe ndërgjegjësim që lidhet me sigurinë kompjuterike.
- ▶ Mundësimi i pagesës së faturave të energjisë nëpërmjet telefonit celular do të kursejë kohë dhe kosto, krahas përmirësimit të shërbimit për klientët.
- ▶ Janë hequr tarifat e trajnimit në qendrat e formimit profesional nga janari 2014.
- ▶ Ngritja e Shërbimit Kombëtar të Rinisë për të siguruar mbështetjen e rinisë në të gjitha fushat, në arsimim, punësim, jetë publike dhe barazi sociale.



@inovacion

mbi 250 aplikime ne konkursin e ideve innovative për administraten publike
#progress #inovacion

@sezoni turistik

për herë të parë një plan i madh vihet në lëvizje për pushime të qeta e të sigurta në sezonin turistik 2014
#progres #siguri

@shëndetësi

për vitin 2014, lista e barnave të rimbursueshme u zgjerua me 56 barna të reja
#progres #siguri

@mirëqenie sociale

Fondi i vitit 2014 për ish të përndjekurit politik 18 mln dollarë
#siguri #progres

@shëndetësi

Lista spitalore e barnave 198 barna me shumë se viti 2013
#siguri #progres

TË BARABARTË MES TË BARABARTËVE

Ne e dinim se puna për një Rilindje shqiptare, si rruga në të cilën ecim më shpejt drejt jetësimit të standardeve europiane në të përditshmen dhe për të ardhmen e qytetarëve shqiptarë nuk do të ishte e lehtë.

Ashtu siç e dinim se pas stabilizimit të situatës ekonomike, financiare dhe të sigurisë në vend, rezultatet e reformave do të kërkonin kohë.

Gjithsesi ne nuk e dinim sa do të mund të ruhej i pandryshuar besimi i 1 milion shqiptarëve që u bashkuan për të hapur një fage të re në historinë e zhvillimit dhe demokratizimit të vendit.

Sot, përveç rezultateve të punës që në shumë fusha qenë përtej pritshmërive tona, është ky besim që rezulton i palëkundur, i cili përbën shtysën kryesore për punë intensive dhe pakompromis.

Në vitin e ri të Qeverisjes ne do të jemi dhe më insistues për arritje në luftën tonë me korrupsionin, padrejtësinë dhe pabarazinë.

Statusi i vendit kandidat dhe procesi i integritetit janë shtysa tjetër themelore për të plotësuar të gjithë mangësitë në këto fusha dhe përparuar në reforma që të dialogojmë me partnerët tanë europianë si të barabartë mes të barabartëve.

Në paqen e parë të vërtetë ballkanike pas më se 100 vite konfliktesh të përgjakshme, duam të bëhemi aktorët kryesorë të bashkëpunimit në rajon dhe të transformimit të imazhit të Ballkanit, të cilin duhet ta kthejmë në një histori europiane suksesi të kohëve të reja.

Një histori suksesi që flet për forcën shqiptare të reformimit dhe transformimit, energjinë ballkanike të bashkërendimit dhe për Ballkanin në Europë si të barabartë mes të barabartëve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KRYEMINISTRIA



www.kryeministria.al



facebook.com/edirama.al



Kryeministria

